

**REXHEP KRASNIQI: “DER BERLINER KONGRESS UND
NORDOSTALBANIA”, Qendra Kombëtare e Kulturës “Arbnori”,
Tiranë, 2007, 209 f.**

Vepra “Der Berliner Kongress und Nordostalbania” është mbajtur si tezë doktore nga prof. Rexhep Krasniqi në Vjenë në vitin 1934. Udhëheqës shkencor ka qenë albanologu i njohur Karl Patch. Vepra është botuar në gjuhën gjermane dhe përkthimi në shqip është bërë nga Qendra Ndërkombëtare e Kulturës “Pjetër Arbërori”, Tiranë 2007.

Botimi në dy gjuhë ka qenë një zgjidhje e mirë për rastin “Krasniqi”, pasi i ka siguruar autorit një audiencë të gjerë nga ata që nuk njohin gjuhën gjermane.

Gjithsesi me rëndësi është botimi gjermanisht i veprës, pasi tregon nivelin shkencor të autorit. Në botim është përfshirë edhe aparati i shënimeve, i literaturës historiografike dhe i burimeve arkivore mbi të cilat mbështetet vepra.

Problemi i parë që del përpara lexuesit kur ndeshet me një vepër të tillë të rëndësishme shkencore, por të kryer gati 90 vjet më parë nga një studiues shqiptar, është sigurisht problemi i nivelit shkencor të saj. Në çfarë niveli paraqitet vepra ?

Në kohën kur prof. Krasniqi ndërmori punën për të hartuar këtë vepër si tezë doktore, historiografia shqiptare ishte në fillimet e veta; temat e saj të mëdha historiografike nuk ishin studiuar siç duhet nga autorë shqiptarë. Po ashtu nuk kishin filluar hulumtimet për dokumente origjinale në arkiva të huaja.

Në këto rrethana, prof. Krasniqi e mori me vetëdije të plotë trajtimin e kësaj teme të vështirë, duke menduar se ishte një nga njohësit më të thellë të gjuhës gjermane, të burimeve dhe dokumenteve të saj. Këtë temë ai e mori si një patriot, për të vënë në pah historinë e vështirë të vendit tonë që fillonte me vendimet e padrejta të këtij kongresi që vendosi copëtimin e tokave shqiptare, kalimin e tyre në kufij të shteteve fqinjë si pasojë e dobësimit të Perandorisë Osmane në çerekun e fundit të shek XIX. Në kohën kur u mbajt Kongresi i Berlinit, Shqipëria vetë nuk kishte miq në arenën ndërkombëtare dhe në këto rrethana vendimet e

Kongresit të Berlinit do të merreshin në favor të shteteve të Ballkanit që tentonin tokat shqiptare.

Nga leximi i veprës rezulton se prof. Krasniqi ka paraqitur drejt këtë histori të dhimbshme të vendit. Ai është mbështetur në një masë të mirë në faktet dhe dokumentet e kohës.

Shënimet që shoqërojnë veprën tregojnë se prof. Krasniqi kishte shfrytëzuar gjerësisht literaturën historike që qarkullonte në kohë të tij lidhur me Kongresin e Berlinit dhe vendimet e tij. Shumë shënime tregojnë se ai kishte shfrytëzuar dokumente arkivore të kohës të Arkivit të Vjenës. Kështu në shën. 39 dhe 44, autori shkruan se “në kapitujt që pasojnë janë shfrytëzuar raportet e konsujve të Austro-Hungarisë për vitet 1871, 1877, 1878, 1879” si dhe raportet e konsujve të Austro-Hungarisë për Prizrenin të Oborrit Mbretëror dhe të Arkivit të Historisë së Vjenës. Në shënimin 50 autori citon “kopje të telegrameve të Kongresit të Berlinit në raportet e Konsujve të Shkodrës Nr. 54, 15 qershor 1878 të Arkivit Shtetëror të Oborrit Mbretëror të Vjenës”. Njoftime të tilla autori jep edhe në shënimet 64, 67.

Krahas burimeve arkivore, prof. Krasniqi ka shfrytëzuar veprat kryesore historike të shkruara nga historianë dhe albanologë të huaj. Autori citon historianin e shquar K.Jirecek dhe veprat e tij “Geschichte der Serben” I, dhe “Albanien in der Vergangenheit” botuar në revistën “Illyrisch Albanische Forschungen” 1916; veprat e historianit kroat M.Shufflay “Serbët dhe shqiptarët” të përkthyer shqip nga Karl Gurakuqi, Tiranë 1926, artikullin e historianit hungarez L.Thaloczy “Das Problem der Errichtung Albaniens” botuar në vëllimin “Illyricsh Albanische Forschungen” 1916. Prof. Krasniqi citon vepra të rëndësishme të albanologëve të njohur, si: veprat e J.Hahn-it “Albanische Studien”, Jena, 1854 dhe “Rise durch Gebite des Drin-Vardar, von Belgrad nach Salonichi”, 1868; veprat e Weigand “Albanische Sprachgebite”, veprën e K.Patch-it, të përkthyer shqip nga Karl Gurakuqi “Gjendja ekonomike-kulturore e Shqipërisë në kohën e kalueme” 1925, veprën e Edit Durham “Slavische Gefahr” Stutgard 1923, si dhe veprën e Th.Ippen “Beitrage zur inneren Geschichte Albanienes”, (botuar në “Illyrische-Albanische Forschungen” 1916).

Prof. Krasniqi ka lexuar po ashtu Pouqueville “Voyage de Grece”, Paris 1820, Ami Bue “Die europaische Turkei”, 1840, Cvijiq “Die ethnographische Abgrenzung”, Kostiq “Nasi gradovi na jugu” (1928) etj.

Me rëndësi këtu është të themi se prof. Rexhep Krasniqi ka konsultuar edhe kontributin e studiuesve shqiptarë në fushën e studimeve historike të periudhës së Rilindjes Kombëtare. Ai citon M.Frashëri “Liga e Prizrenit”, Tiranë, 1927; Revistën “Dituria”, vol. II-III, botuar në vitet 1927, 1928 ku trajtoheshin artikuj historikë, si: Oso Kuka; Lufta e Kernices, (1885); Lufta e Shestanit dhe Muriqit; Lufta ndërmjet shqiptarëve dhe malazezëve; librin e K.Dako “Liga e Prizrenit”, Bukuresht 1922; revistën me artikuj historikë “Kalendari Kombiar” (1928) të botuar nga Lumo Skëndo etj.

Prof. Rexhep Krasniqi është përpjekur të trajtojë në mënyrë serioze problemin që ka marrë në shqyrtim. Ky qëndrim i ka siguruar veprës një rezultat të mirë shkencor. Këtu i tërheqim vëmendjen lexuesit të sotëm për trajtimin me sukses të plotë nga autori të problemit të “kufijve etnikë të shqiptarëve në Mesjetë”. Në trajtimin e këtij problemi prof. Krasniqi ka pasur parasysh qëndrimin e gabuar të autorëve të huaj dhe ka ditur të mbajë një qëndrim kritik shkencor të drejtë ndaj tyre. “Hapësira gjeografike e shqiptarëve të mesjetës-shkruan Krasniqi- ka qenë brenda katërkëndëshit Shkodër-Prizren-Ohër-Vlorë”. Autori citon studiuesin K Jirecek. që thotë këtë, por prof. Krasniqi shton menjëherë se “populli shqiptar ekzistonte megjithatë edhe përtej këtyre kufijve veçanërisht në veri dhe në lindje”¹.

Autori vijon më pas të përshkruajë me hollësi vijën e kufirit midis popullit tonë dhe atij sllav. “Ndarja e kufirit midis popullit shqiptar e atij sllav - shkruan Krasniqi- fillon qysh në gjirin Spiza në veri të Tivarit”. Prof. Krasniqi ka meritën që përcakton se ku shtriheshin këta kufij veriorë të Shqipërisë, që shkonin nga gjiri i Shpizës deri në Kosovë dhe Manastir. Duke lexuar veprën gjykojmë se autori ka bërë këtu një punë shkencore të shkëlqyer për përcaktimin e saktë të këtyre kufijve. (Shih pikën 2 të kapitullit I të titulluar “Ethnographische grenzes des albanertums in Nordsten”, f.126)

Vepra nuk ka vlerën e një studimi të thjeshtë historik, që tregon ngjarjet në mënyrë pasive. Vepra ka karakter polemik për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e popullit shqiptar të marra nëpër këmbë nga Fuqitë e Mëdha. Kjo është një meritë e veçantë e kësaj vepre që vlerësohet nga lexuesit e sotëm shqiptarë.

¹ Albanisches Volkstum existierte jedoch auch ausserhalb diese Grenzen, bwsonders in Norden und Osten.

Po kush është prof. dr.Rexhep Krasniqi ?

Prof. Krasniqi është një emër i madh në historinë e Shqipërisë. Ai ka lindur në Gjakovë më 1906 dhe ka vdekur në USA në 2000. Ai ka qenë Ministër i Arsimit në qeverinë e Mehdi Frashërit, dhe më pas gjatë luftës ka qenë nënkryetar i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Prof. Krasniqi ka qenë gjithashtu edhe Kryetar i Parlamentit Shqiptar në periudhën e pushtimit gjerman të vendit. Siç shihet, prof. Krasniqi ka qenë një emër i rëndësishëm i politikës shqiptare i periudhës së Luftës II Botërore. Ai nuk ka qenë i angazhuar në radhët e Partisë Komuniste Shqiptare, prandaj ai dhe figura të tjera të shquara, si Mid'hat Frashëri janë gjykuar nga komunistët që fituan luftën si tradhtarë dhe armiq të atdheut. Por a është i tillë prof. Rexhep Krasniqi, a mund të qëndrojë për historianët e sotëm ky emërtim i politikës së majtë që është bërë në rrethanat e luftës, për shkak se ai nuk u radhit në anën e komunistëve shqiptarë?

Për të gjykuar në këtë pikë ndihmon shumë “Hyrja” që ka shkruar vetë prof. Krasniqi në veprën e tij. “Hyrja” nuk ka asnjë lidhje me librin “Kongresi i Berlinit”. Prof. Krasniqi nuk diskuton këtu për vështirësitë e trajtimit të temës, për mungesën e burimeve dhe të literaturës historike etj. Kjo hyrje, e cila shkon deri në 30 faqe, merret në fakt me historinë e Shqipërisë në vitet e Luftës së Parë Botërore 1913-1921. Në të autori tregon ngjarjet që kalonte vendi. Autori jep këtu edhe kujtimet kur ishte një djalë i vogël. Këto kujtime flasin për karakterin e prof. Krasniqit, për interesat e tij të lidhura ngushtë me fatet e popullit të Kosovës.

Autori shkruan për pushtimin e Kosovës nga serbët. Autori tregon ngjarjet kur ushtria franceze hyri në Kosovë dhe mikpritjen që treguan kosovarët ndaj francezëve. Në takimet që bënë me ta, klerikët e lartë kosovarë i kërkonin gjeneralit francez të ndikonte pranë qeverisë së tij për bashkimin e Kosovës me Shqipërinë. Autori shkruan se i gjithë ky ishte një mashtrim i madh, sepse pas largimit të ushtrisë franceze Kosova u pushtua nga ushtria serbe, e cila mbante veshur kostumin e rrobave të ushtrisë franceze. Prof. Krasniqi ka lënë në këtë hyrje kujtimet që ka mbledhur për vrasjen rrëqethëse të Isa Boletinit nga malazezët. Këtë figurë legjendare ai e donte në mënyrën të jashtëzakonshme për kontributin e tij në luftën për liri e pavarësi të popullit shqiptar. Me këtë nderim ai kujtonte burrat e tjerë të mëdhenj të kombit shqiptar, si: Bajram Curri dhe Hasan Prishtina.

Nga “Hyrja” kuptohet se Rexhep Krasniqi jetonte në rrethin familjar të Bajram Currit. Kjo shpjegon përse prof. Rexhep Krasniqi,

ndonëse i vogël, i përjetonte ngjarjet si një burrë i rritur. Këto lidhje ishin të thella. Autori tregon në kujtimet e tij se ishte vetë Bajram Curri që mendonte t'a dërgonte të vijonte studimet e larta në Vjenë.

Në Vjenë prof. Krasniqi vijoi të ishte i lidhur ngushtë me vendin e tij Kosovën dhe Shqipërinë, të cilat ishin të ndara për shkak të vendimeve të padrejta të Kongresit të Berlinit. Kjo ishte arsyeja përse autori u mor me Kongresin e Berlinit.

Vepra e prof. Krasniqit “Der Berliner Kongress und Nordostalbania” bie vonë në duart e shqiptarëve, por pavarësisht nga ky fakt, ajo ka vendin e saj të merituar në historiografinë shqiptare për vlerat e saj shkencore.

Luan MALLTEZI

